
**RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË
KOMISARIATET E POLICISË**

NËNTOR – DHJETOR 2011

1. HYRJE

Në periudhën Nëntor – Dhjetor 2011, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka realizuar disa raunde vëzhgimesh në Drejtoritë e Policisë në disa Qarqe të vendit¹ dhe në disa nga Komisarariatet e Policisë që mbulohen nga këto Drejtori. Komisarariatet që u vëzhguan ishin: Komisarati i Policisë nr.1, nr.2, nr.3 dhe i Kamzës në Tiranë, Komisarati i Policisë së Gjirokastrës, Sarandës, Vlorës, Korçës, Pogradecit, Lushnjës, Beratit, Fierit, Elbasanit, Librazhdit, Lezhës, Shkodrës, Krujës, Fushë Krujës dhe Kukësit. Përveç vëzhgimit të kushteve fizike të këtyre Komisariateve, vëzhguesit e KShH-së zhvilluan takime me përfaqësues të Drejtorive të Policisë në Qarqe dhe të Komisariateve të Policisë si dhe morrën kontakt me personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar që mbaheshin në ambientet e komisariateve.

Vëzhgimet e kryera kanë patur në fokus kushtet infrastrukturore të ambienteve të Komisariateve të Policisë dhe pajisjen e tyre me mjete logjistike që lehtësojnë kryerjen e detyrave; respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë; marrjen e informacionit lidhur me procedurat ligjore për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë; evidentimin e gjendjes së kriminalitetit në vija të përgjithshme në shkallë qarku; etj.

Qëllimi i këtij raporti është të evidentojë problematikën lidhur me kushtet dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë, që mbahen në Komisarariatet e Policisë, si dhe të kontribuojë me rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në të ardhmen.

Standartet e aplikuara gjatë realizimit të këtyre vëzhgimeve kanë qenë ato të parashikuara në legjisllacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Në mënyrë të veçantë janë patur në konsideratë Rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, standartet dhe parimet e njohura të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe Ligji “Për Policinë e Shtetit” (i ndryshuar).

2. Problematika e konstatuar

2.1 Infrastruktura dhe Kushtet Fizike të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë

Infrastruktura bazë dhe kushtet e përshtatshme fizike të ambienteve të Komisariateve të Policisë janë ndër elementët thelbësorë për sigurimin e një trajtimi human dhe respektimin e të drejtave të personave që mbahen në cilësinë e të shoqëruarve, ndaluarve ose arrestuarve në flagrancë.

Nga monitorimet e kryera u konstatuan përmirësime të dukshme të situatës në Komisarariatet e rretheve Kukës, Korçë, Gjirokastër dhe Fier, ambientet e të cilave ishin

¹ Drejtoritë e Policisë së Qarkut Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Sarandë, Vlorë, Korçë, Berat, Fier, Elbasan, Lezhë, Shkodër dhe Kukës.

rikonstruktuar tërësisht. Megjithatë, një nga problemet e vërejtura në ambientet e këtyre komisariateve ishte ndërtimi i tualeteve dhe i dusheve brenda dhomave të sigurisë, të cilat shiheshin, lehtësisht, që nga dera e dhomës. KShH vlerëson se, pozicionimi i tualeteve në këtë mënyrë, çënon privatsinë e personave të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar që mbahen në këto ambiente dhe përbën një trajtim johuman për ta, aq më tepër kur në këto dhoma qëndrojnë të mitur, gra ose dhe dy persona dhe duhet të kryejnë nevojat e tyre në kushte pa privatësinë e nevojshme. Ky fakt u konstatua në Komisaritet e Kukësit dhe Fierit.

Në ndryshim nga komisaritet e tjera të ndërtuar rishtas, ai i Korçës nuk kishte filluar ende nga funksionimi. Shkak për vonesën, sipas personelit, ishin disa punime të vogla elektrike që po vazhdonin të kryheshin. Personat e shoqëruar, ndaluar ose arrestuar në këtë Komisariat, transferoheshin në Komisaritin e Pogradecit, i cili kishte kapacitet të kufizuar, me dy dhoma shoqërimi dhe dy dhoma sigurie, këto të fundit në një ndërtim të vjetër, me standard të ulët jetese, duke shkaktuar ngarkesë dhe mbipopullim për këtë komisariat.

KShH vëren me keqardhje se, në pjesën më të madhe të komisariateve ekzistonin pothuajse të njëjtat problematika të evidentuara nga KShH në vëzhgimet e mëparshme. Infrastruktura dhe kushtet fizike në këto komisariate nuk ishte në përputhje me standartet e parashikuara dhe çënojnë dinjitetin dhe të drejtat e personave që mbaheshin në ambientet e shoqërimin dhe dhomat e sigurisë. Problemet e konstatuara kishin të bënin me praninë e lagështirës, kubaturën e vogël të dhomave, ndriçimin e dobët natyror dhe elektrik, në disa raste, probleme me ajrimin, mungesa e pajisjeve të nevojshme për fjetje si krevatat, dyshek, mungesa e ngrohjes, e banjave të përshtatshme dhe higjienike etj. Kjo problematikë u vërejt në Komisaritet e Tiranës², Sarandës, Durrësit, Lushnjës, Krujës, Vlorës, Elbasanit, Pogradecit dhe stacionin e policisë të Librazhdit.

Në kushte shumë të rënda infrastrukurore ishin veçanërisht Komisaritet e Lushnjës, Vlorës, Sarandës, Krujës dhe Shkodrës. Në Komisaritin e Lushnjës, dhomat e sigurisë ishin në katin e nëndheshëm. Vendosja në katin e nëndheshëm shkaktonte probleme serioze me ajrimin dhe ndriçimin natyral të ambienteve të dhomave të sigurisë. Gjithashtu, në Komisaritet e Sarandës, Vlorës dhe Shkodrës, ajri ishte shumë i rëndë si rezultat i lagështirës, muret ishin të palyera dhe ambientet ishin të papastra.

Në disa nga Komisaritet e vëzhguara mungonin ambientet e veçanta për të miturit dhe femrat. Ky fakt u konstatua në: Komisaritin e Kamzës, Komisaritin nr.1, nr.2³ dhe nr. 3 në Tiranë⁴, Komisaritin e Sarandës⁵ dhe Komisaritin e Shkodrës⁶. Gjithashtu, në një pjesë të konsiderueshme të komisariateve nuk kishte dhoma sigurie për personat e ndaluar dhe arrestuar si në: Komisaritin e Beratit, Mallakastrës, Hasit, Mirditës, Laçit, Pukës, Malësisë së Madhe, Gramshit, Peqinit, stacioneve të policisë së Librazhdit dhe Fushë Krujës, etj. Veçanërisht, ky problem ishte tepër shqetësues në Komisaritin e Beratit, ku personat e ndaluar dhe arrestuar në flagrancë transferoheshin në Komisaritin e Lushnjës. Kjo sillte probleme për sa i takon ngarkesës që i shkaktonte stafit të komisaritatit të Beratit, që duhej të angazhohej me transferimin e këtyre personave, me rritjen e nevojës për karburante, me nevojën e mjeteve shtesë të transportit etj. Në

² Komisaritet e Kamzës, Komisaritin nr.1, Komisaritatit nr.2 (dhoma e sigurisë) dhe Komisaritin nr.3

³ Komisariti nr.2 kishte vetëm dhoma shoqërimi për të mitur dhe femra dhe jo dhoma sigurie.

⁴ Këto komisariate i transferonin të miturit dhe femrat në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

⁵ Në komisaritin e Sarandës, gratë e shoqëruara mbaheshin në ambientet e administratës së institucionit ndërsa ato të ndaluar mbaheshin në një prej dhomave të Komisaritatit, duke u veçuar nga meshkujt.

⁶ Në këtë komisariat nuk kishte dhoma të posaçme për të miturit dhe femrat mgjth kur kishte femra ose të mitur, numri i dhomave ishte i mjaftueshëm për të bërë ndarjen nga meshkujt dhe të rriturit.

Komisariatet e tjera, që nuk kishin dhoma sigurie, personat e ndaluar ose të arrestuar transferoheshin në komisariatit më të afërt brenda qarkut të policisë.

KShH vlerëson se transferimi nga një komisariat në tjetrin i personave të ndaluar dhe arrestuar, për arsye të mungesës së dhomave të sigurisë, mund të çojë në shkeljen e afateve procedurale të ndalimit ose arrestimit në flagrancë, si rezultat i mospasqyrim të saktë të orarit hyrës-dalës në regjistrat për personat e ndaluar dhe arrestuar në komisariatit ku kapet personi i ndaluar/arrestuar si dhe në komisariatit ku bëhet transferimi. Një rast i tillë u evidentua në Komisariatit e Librazhdit⁷.

Për sa i takon pajisjes me mjete logjistike, u vërejtën mungesa në disa Komisariate, si për shembull mungesë e karburantit të nevojshëm; pamjaftueshmëri të mjeteve të transportit për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar; mungesë të dedektorëve për kontrollin fizik të personave; probleme me amortizimin e sistemit kompjuterik etj.

Shumë shqetësues ishte fakti i dëmtimit dhe ndotja e ambienteve të dhomave të shoqërimit dhe të pajisjeve të tyre, nga personat e alkoolizuar ose përdorues të lëndëve narkotike, të cilët mbaheshin në këto ambiente, në cilësinë e personave të shoqëruar. Ky problem ishte prezent edhe në ambientet e dhomave të shoqërimit të rikonstruara në komisariatet e Lezhës, Fierit, Elbasanit dhe Pogradecit. Si rezultat i këtyre dëmtimeve, në disa nga ambientet e shoqërimit të këtyre komisariateve, si dhe në komisariate të tjera, mungonin pajisjet e nevojshme për uljen e personave të shoqëruar, të cilët ishin të detyruar të qëndronin në këmbë deri në maksimumin e afatit të parashikuar në ligj prej 10 orësh. Personeli me uniformë e këtyre komisariateve, në disa raste, pretendoi se kjo kategori personash të shoqëruar përdorte shprehje fyese dhe i sulmonte fizikisht ata.

2.2 Kushtet higjino – sanitare

Mungesa e ujit të ngrohtë dhe e dusheve në disa komisariate, si në Komisaritat nr.3 të Tiranës, Kamzës, Sarandës, Pogradecit, Durrësit, Elbasanit, shkaktonte vështirësi për mbajtjen e higjienës personale të personave që qëndronin në ambientet e këtyre komisariateve, për më shumë se 72 orë.

Në disa komisariate u vërejtën kushte të këqija higjieno – sanitare sidomos të tualeteve, të cilat vinin erë e keqe. Ky problem u konstatua në Komisaritat e Policisë nr.3 në Tiranë, Sarandës dhe Elbasanit. Në Komisaritat e Pogradecit, ambientet e dhomave të shoqërimit vinin era ‘urinë’ dhe veç kësaj kishte papastërti të tjera. Fjetja në dysheme e personave të ndaluar/arrestuar në disa komisariate, pa dyshekë e batanije, ishte në kundërshtim me rregullat e higjienës personale të personave.

2.3 Kapaciteti

Duke qenë se kushtet infrastrukturore, në pjesën më të madhe të komisariateve të vëzhguara, nuk kanë ndryshuar KShH konstatoi sërish se kapaciteti, që ofrojnë ambientet e këtyre komisariateve, nuk është i mjaftueshëm në rastet e fluksit maksimal dhe për pasojë shkakton mbipopullim. Problematike paraqitet situata në Drejtoritë e

⁷ Rasti i një të mituri, i cili ishte kapur në flagrancë për vjedhje në qytetin e Librazhdit. I mituri ishte mbajtur për 8 orë e gjysëm në ambientet e Komisaritatit të Librazhdit dhe në orën 6:30 të mëngjesit, sipas regjistrat për personat e ndaluar/arrestuar të këtij komisariatit figuronte se ishte transferuar për në Komisaritat e Elbasanit. Në regjistrin e Komisaritatit të Elbasanit, i mituri figuronte se kishte hyrë në orën 14:30 të së njëjtës ditë, në ambientet e dhomave të sigurisë, pra me një diferencë prej 8 orësh nga koha kur kishte dalë nga Komisaritatit i Librazhdit, ndërkohë që distance në kohë nga Librazhdi në Pogradec është gjysëm ore.

Policisë në Qarqe, të cilat mbulojnë disa komisariate dhe ku vetëm një nga këto komisariate ka dhoma sigurie për personat e ndaluar dhe arrestuar në flagrancë, që i shërben gjitha Qarkut.

Gjatë kohës së vëzhgimit u konstatua mbipopullim në disa komisariate si në Komisaratin nr.2 në Tiranë, ku u gjendën të sistemuar 3 persona të ndaluar në një dhomë sigurie, 2 prej të cilëve, për shkak të mungesës së krevateve, flinin në tokë, ndërkohë që në Komisaratin e Durrësit ishin vendosur 8 persona në një dhomë nga sigurisë.

Mungesa e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Beratit dhe transferimi nga ky komisarit i të gjithë personave të ndaluar dhe të arrestuar në dhomat e sigurisë së Komisaratis të Lushnjës, kishte shkaktuar mjaft probleme në drejtim të mbipopullimit të atij Komisarati. Kishte patur raste kur në dhomat e sigurisë së Komisaratis të Lushnjës, në raste fluksi, ishin vendosur 15 persona në një dhomë, duke shkaktuar mbipopullim në nivel ekstrem.

2.4 Organika e stafit

U konstatuan mungesa të stafit femër të veshur me uniformë në Komisaratin e Sarandës, Hasit, Tropojës, Lezhës si dhe në Stacionet e Policisë pranë disa drejtorive. Pavarsisht se kontrolli i femrave të shoqëruara, ndaluara dhe arrestuara në këto komisariate bëhej nga stafi femër i administratës ose nga stafi femër i policisë kufitare, KShH konsideron si shumë të rëndësishme praninë e stafit femër me uniformë në këto komisariate, veçanërisht për sa i takon mbikqyrjes së femrave të ndaluara dhe të arrestuara gjatë qëndrimit të tyre në dhomat e sigurisë dhe ofrimit të kujdesit për to, në raste të veçanta. KShH vlerëson masat e marra në disa komisariate ku ishin reklamuar postera, që inkurajonin femrat të aplikonin në strukturat e policisë. Mendojmë se kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të femrave që kanë aplikuar këtë vit për në Shkollën e Policisë së Shtetit.

U vërejtën probleme edhe në drejtim të mungesave të stafit, në disa nga komisaritet, sidomos për pozicionin e mjekut dhe psikologut, me kohë të plotë. Në Komisaratin e Gjirokastrës, pozicioni i mjekut ishte vakant⁸ dhe psikologu sigurohej atëherë kur ishte e nevojshme në bazë të një kontrate të lidhur me Universitetin Publik të Gjirokastrës. Në Komisaratin e Sarandës nuk kishte psikolog dhe as staf mjekësor⁹. Në Komisaratin e Pogradecit mungonte në organikë psikologu. Në disa komisariate si Lezha¹⁰, Shkodra dhe Librazhdi, mjeku është përfshirë vetëm në organikën e Drejtorisë përkatëse të Policisë së Qarkut, që përfshin këto komisariate dhe shërbimi sigurohet nga ai mjek. Në disa komisariate, si në Lezhë dhe Librazhd, nevojat për psikolog i mbulonte Drejtoria e Qarkut që i kishte në varësi, nëpërmjet stafit që kryente edhe funksione të tjera si zëdhënës etj. Një situatë e tillë krijonte vonesa për marrjen në pyetje të personave që e kanë të detyrueshme, sipas ligjit, praninë e psikologut.

Në Komisaritet Sarandë, Kukës, Vlorë dhe Tropojë, kishte mungesa të punonjësve të policisë në sektorët e parandalimit dhe hetimit të krimeve etj.

⁸ Nevojat për mjek në këtë komisaritet plotësoheshin duke marrë mjek part-time, sipas nevojave, një mjek nga spitali i Gjirokastrës ose duke e dërguar vetë personin në spital.

⁹ Në raste nevojë psikologu vjen nga Komisariteti i Gjirokastrës ndërsa për shërbimin mjekësor, thirrej një mjek nga urgjenca e spitalit të Sarandës. Në këtë spital ndodhej një dhomë sigurie e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme të sigurisë për trajtimin e specializuar mjekësor të personave të ndaluar/arrestuar në flagrancë.

¹⁰ Edhe në Spitalin e Lezhës është krijuar një dhomë e posaçme për personat e ndaluar/arrestuar në Komisaratin e Lezhës.

2.5 Ushqimi

Për sa i takon sigurimit të ushqimit, KShH vërejti se krahasimisht me vitet e kaluara kishte përmirësim të dukshëm në disa komisariate, të cilat kishin gjetur zgjidhje alternative për ofrimin e këtij shërbimi, si psh: ofrimi i ushqimit catering nëpërmjet kontraktimit të firmave private, sigurimi i ushqimit nëpërmjet mençës që funksiononte në ambientet e komisarariatit, ose në ambientet e paraburgimit për ato komisariate që ishin afër me paraburgimin.

Ushqimi catering sigurohej në Komisarariat e Kamzës, Komisarariat nr.1, nr.2 dhe nr.3 në Tiranë, në Komisarariat e Gjirokastrës, Komisarariat e Fierit dhe Komisarariat e Lezhës. Në Komisarariat e Kukësit dhe të Sarandës, ushqimi mundësohej nga mençat e paraburgimeve, që ishin në të njëjtën godinë, ose ngjitur me komisarariatet. Komisarariatet e Lushnjës dhe Elbasanit kishin vetë mençë gatimi.

Në Komisarariat e Pogradecit dhe stacioni i policisë Librazhd nuk u ofrohej ushqim personave që mbaheshin aty. Këto komisariate deklaruan se nuk kishin në dispozicion fonde për të mundësuar ofrimin e këtij shërbimi. Në komisarariatet e Korçës ishin në proces e sipër procedurat për prokurimin e shërbimit catering.

2.6 Respektimi i procedurës për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar

- **Respektimi i afateve**

Ligji “Policinë e Shtetit” parashikon se “Mbajtja e personave në Polici zgjat derisa çështja, për të cilën është kryer shoqërimi, verifikohet, por në çdo rast jo më shumë se 10 orë”. Kodi i Procedurës Penale parashikon se, “Oficerët e policisë gjyqësore duhet të vënë të arrestuarin/ ndaluarin në dispozicion të prokurorit sa më shpejt të jetë e mundur. Kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, prokurori, brenda 48 orë nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi/ndalimi. Vendimi i Gjykatës për vleftësimin e masës duhet të shpallet brenda 48 orë nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë. Nëse prokuroria dhe gjykata nuk respektojnë afatet e parashikuara, arrestimi ose ndalimi e humbasin fuqinë”.

Lidhur me sa më sipër, KShH konsideron si një problem shqetësues mbajtjen për një kohë të gjatë të personave të dënuar në mungesë, të cilët kapen nga strukturat e policisë së shtetit dhe shoqërohen në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisarariatet e Policisë. Afati i mbajtjes së këtyre personave, të gjetur në Komisarariatet e vëzhguara, varioonte mesatarisht nga 7-10 ditë. Ky problem u konstatua në pothuajse të gjitha komisarariatet e vëzhguara, me përjashtim të Komisarariatit të Lezhës, i cili i transferonte personat në I.E.V.P-në Shën Koll. Një ndër arsytet e mbajtjes për një kohë të gjatë të kësaj kategorie në ambientet e komisariateve ishte mungesa e koordinimit midis strukturave përgjegjëse dhe në disa raste vonesa të shkaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për nxjerrjen e urdhërave të transferimit.

Në disa komisariate si në Komisarariat nr.2 në Tiranë dhe në Komisarariatet e Lushnjës, u konstatua mbajtja e personave në ambientet e dhomave të sigurisë edhe mbas vleftësimit të masës së sigurisë “arrest në burg” nga gjykata. Transferimi i personave të ndaluar dhe arrestuar nga Stacioni i policisë së Librazhdit, i cili nuk ka dhoma sigurie, në Komisarariatet e Elbasanit sjell dhe shkelje të këtyre afateve, si në rastin e një të mituri, i cili ishte mbajtur si i shoqëruar më shumë se 10 orë, duke llogaritur këtu qëndrimin në

Stacionin e policisë së Librazhdit dhe në Komisariatin e Elbasanit, ku ishte transferuar më pas.

Në kuadër të konstatimeve të bëra më sipër, KShH vlerëson se respektimi i afateve të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të parashikuara në ligj është shumë i rëndësishëm dhe përbën një garanci procedurale, që ligji ka parashikuar për të realizuar efektivisht të drejtën e personave për liri dhe siguri. Gjithashtu, KShH vlerëson se mbajtja në dhomat e sigurisë në komisaritet e policisë, të personave të dënuar në mungesë dhe personave ndaj të cilëve është dhënë masa e sigurisë “arrest në burg” përbën shkelje të të drejtave të këtyre personave, të cilët sipas legjislacionit tonë duhet të qëndrojnë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe duhen trajtuar në përputhje me ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

- ***Shkaqet e shoqërimit, ndalimit, arrestimit dhe informimi i personave me të drejtat dhe detyrat e tyre***

Për shoqërimin, ndalimin dhe arrestimin në flagrancë të personave, Ligji “Për Policinë e Shtetit” dhe Kodi i Procedurës Penale parashikojnë shkaqet dhe kushtet në të cilët kufizohet liria e personit të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar në flagrancë. Gjithashtu, neni 5/1 i KEDNJ-së parashikon rastet në të cilat kufizohet liria e personit. Sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së, për të përcaktuar nëse ka patur kufizim të lirisë, duhet parë si pikë fillestare situata specifike e personit të përfshirë në një situatë të tillë dhe duhen mbajtur në konsideratë tërësia e faktorëve të çështjes në fjalë si tipi, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e zbatimit të masës përkatëse.

Në çështjen *Benham k. Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ konstaton se neni 5/1 i KEDNJ-së kërkon që *kufizimi i lirisë të jetë i ligjshëm*, duke përfshirë kushtin që të jetë *në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj*. Konventa në thelb i referohet legjislacionit kombëtar të shteteve dhe përcakton detyrimin e tyre që t’i binden rregullave substanciale dhe procedurale, por gjithashtu kërkon që çdo kufizim lirie të jetë i pajtueshëm me qëllimin e nenit 5, në mënyrë që individët të mbrohen nga arbitrariteti.

Nga vëzhgimet e bëra në komisaritet e policisë, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se, në disa nga rastet e shoqërimit të personave në ambientet e Komisaritatit të Policisë, nuk respektoheshin shkaqet e shoqërimit të parashikuara në Ligjin “Për policinë e Shtetit”. Neni 101 i këtij ligji parashikon se *“Punonjësi i Policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e Policisë ose në organin urdhërdhënës në rastet e mëposhtme: a) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; b) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë”*. Në të gjitha komisaritet e vëzhguara, janë shoqëruar persona që ishin të dyshuar për kryerjen e një krimi, të cilët, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit i nënshtroheshin verifikimeve të nevojshme të dokumentacionit dhe në disa raste u merreshin shenjat e gishtave. Kjo praktikë ishte e paunifikuar në komisaritate të ndryshme. Nëse gjatë periudhës së shoqërimit, nga verifikimi i dokumentacionit ose nga shenjat e gishtrinjeve rezultonte i provuar dyshimi i policisë, personi vendosej në ambientet e shoqërimit dhe më pas ndiqeshin procedurat e parashikuara për ndalimin.

Në vlerësimin e GjEDNJ-së edhe nëse personit nuk i është akorduar formalisht statusi i personit të dyshuar, fakti që ai trajtohet *de facto* si i dyshuar, vë në pikpyetje respektimin e kërkesave të parashikuara në nenin 5/1 të Konventës. Në çështjen *Khodorkosvskiy k. Rusisë*, GjEDNJ ka konstatuar se *“Kufizimi i lirisë mund të jetë i paligjshëm, nëse*

shkaku për të cilën ai kryhet ndryshon nga ai i vërtetë ... Rrethanat e arrestimit të ankuesit, tregojnë se edhe pse formalisht, ai u shoqërua në stacionin e policisë si dëshmitar, qëllimi i vërtetë i hetuesit ishte të ngarkonte ankuesin si të pandehur dhe për të kaluar nga skena e procedurës eventuale të ndalimit tek një procedurë më bindëse”.

Objekt i vëzhgimit në komisariate ishte edhe respektimi i urdhërit nr.562, dt.16.06.2011 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin dhe vënien në zbatim të “Deklaratës për informimin dhe njohjen me të drejtat ligjore, për personat e arrestuar/ndaluar në Policinë e Shtetit”, gjatë arrestimit/ndalimit dhe qëndrimit në ambientet e dhomave të sigurisë. Kjo deklaratë i është përcjellë KShH-së në dt.22.06.2011 nga Departamenti i Sigurisë Publike në DPPSH. Qëllimi i këtij urdhëri ishte marrja e masave për respektimin, garantimin e lirive dhe të drejtave ligjore për personat e arrestuar/ndaluar në ambientet e policisë, nëpërmjet njohjes së të interesuarve me këto të drejta.

KShH konstatoi me keqardhje se ky urdhër nuk kishte gjetur zbatim në asnjë nga komisaritet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimit, përfaqësuesit e Drejtorive të Policisë në qarqe dhe të komisariateve informonin se ishin në dijeni të këtij urdhëri dhe se deklarata kishte gjetur zbatim në institucionin e tyre, por nga verifikimet e kryera prej vëzhguesve të KShH-së, u konstatua se jo vetëm që kjo deklaratë nuk përdorej por, asnjë nga komisaritet e vëzhguara, përveç Komisaritetit të Shkodrës, nuk e dispononte atë në formë të shkruar e shumfishuar.

Është për t’u vlerësuar si pozitiv fakti që në ambientet e disa komisariateve, si Komisariteti i Kamzës, nr.1, nr.2 dhe nr.3 në Tiranë, i Durrësit, Gjirokastrës, Kukësit, etj ishin afishuar postera sensibilizues që përmbanin të drejtat e personave të arrestuar/ndaluar. Megjithatë, kishte komisariate si ai i Pogradecit dhe i Vlorës, të cilët nuk kishte asnjë material sensibilizues për të drejtat e personave të ndaluar dhe shoqëruar. Nga kontakti që vëzhguesit e KShH-së patën me disa nga personat e ndaluar në Komisaritetin nr.3 në Tiranë, Durrësit dhe Elbasanit, personat pretendonin se nuk ishin informuar nga oficerët e policisë gjyqësore për të drejtat e tyre, ose në disa raste personat e kontaktuar ishin konfuzë në dhënien e përgjigjies.

- ***Mbajtja dhe hedhja e të dhënave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar***

KShH vlerëson si hap pozitiv që në pjesën më të madhe të Komisariateve ishte duke u aplikuar sistemi elektronik i hedhjes dhe përpunimit të të dhënave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar (Sistemi ADAM). Hedhja e të dhënave bëhej në përputhje me manualin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të dt.07/03/2010 “*Mbi krijimin e bankës qendrore elektronike për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë*”. Një nga problemet e vërejtura, për sa i takon aplikimit të sistemit ADAM, ishte mungesa e njohurive të mjaftueshme dhe nevoja për trajnime të mëtejshme për personelin operativ të ngarkuar me hedhjen e këtyre të dhënave.

Para se të dhënat të hidheshin në sistemin elektronik ADAM, procedohej fillimisht me hedhjen manuale të të dhënave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në regjistrat përkatës që administroheshin nga stafi i komisaritetit. KShH vlerëson se duhet përmirësuar puna dhe metodologjia që përdoret nga Komisaritetet për hedhjen e të

dhënave manualisht në këto regjistra. Në dy raste¹¹ të personave të shoqëruar, u vërejt se edhe pse ata qëndronin në ambientet e dhomave të shoqërimit prej disa orësh, të dhënat e tyre nuk ishin hedhur ende në regjistër por mbaheshin, nga stafi i ngarkuar me këtë detyrë, në fletushka të vogla. Gjithashtu, KShH thekson se është shumë i rëndësishëm pasqyrimi i saktë, në regjistrat përkatës, i orës së hyrjes dhe daljes së personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar, nga komisaritet. KShH vlerëson se brenda çdo komisariti duhet të funksionojë një mekanizëm efektiv i brendshëm, që të mbikqyrë saktësinë dhe rregullshmërinë e hedhjes së të dhënave në regjistrat manualë dhe më pas në sistemin elektronik ADAM.

2.7 Trajtimi Human

Gjatë periudhës së realizimit të monitorimeve të planifikuara në Komisaritet e Policisë në periudhën Nëntor – Dhjetor 2011, vëzhguesit e KShH-së kontaktuan një numër relativisht të vogël personash që ndodheshin në ambientet e komisariteve, me cilësinë e personave të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar. Asnjë nga personat e kontaktuar nuk pati ankesa për sa i takon ushtrimin të dhunës ose keqtrajtimit nga stafi me uniformë i policisë. Megjithatë, gjatë vitit 2011, në kuadër të programit “Klinika Ligjore Falas”, KShH ka marrë ankesa nga persona të privuar nga liria në institucionet e paraburgimit dhe burgje, të cilët pretendojnë ushtrim dhune nga forcat e policisë, gjatë kohës së shoqërimit dhe qëndrimit të tyre në komisaritet e policisë. Për arsye se këto ankesa kanë ardhur mbas një kohe relativisht të gjatë nga dita e transferimit të tyre nga komisariti në paraburgim ose në burg, KShH e ka patur të pamundur verifikimin e këtyre ankesave.

Për sa i takon rasteve të dhunës së ushtruar nga policia për vitin 2011, KShH ka reaguar nëpërmjet deklaratave publike në dy raste, respektivisht për dhunën e ushtruar nga policia ndaj protestuesve në demonstratën e dt. 21 Janar 2011 dhe për dhunën e ushtruar nga forcat e policisë ndaj vëllezërve U.M dhe Sh.M, teksa po ktheheshin nga një tubim i zhvilluar para selisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në dt.20 Maj 2011. KSHH ka konstatuar edhe dhunimin e të drejtave të familjarëve të të shoqëruarve në komisaritet e policisë, për shkak të ngjarjes së 21 Janarit 2011, të cilëve u refuzohej çdo lloj informacioni, nga stafi policor, rreth situatës së familjarëve të tyre, vendit se ku ndodheshin, shkakun e shoqërimit etj.

KShH dëshiron të evidentojë në këtë raport edhe konstatimet e publikuara në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2011, ku ndër të tjerash nënvizohet se *“Në Shqipëri nuk është siguruar zbatimi i garancive procedurale kundër forcës së tejkualuar që ushtrohet nga punonjësit e policisë... Rastet e keqtrajtimit dhe të forcës së tejkualuar vazhdojnë të raportohen, veçanërisht gjatë arrestimit dhe mbajtjes së personit në mbikqyrjen e policisë. Këto abuzime u raportuan në vijim të ngjarjeve të 21 Janarit 2011. ... Nuk ka prova për progres thelbësor në drejtim të rritjes së ndjekjes gjyqësore të çështjeve të keqtrajtimit”*.

KShH sjell, gjithashtu, në vëmendje të autoriteteve shqiptare rekomandimet e bëra nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT)¹², nëpërmjet të cilave i bëhet thirrje këtyre autoriteteve *“të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga policia, në dritën e vërejtjeve të bëra në raportin e KPT-së. Veçanërisht, të gjithë oficerët e policisë duhet të informohen, në intervale kohe periodike, se format e keqtrajtimit të personave të ndaluar janë të papranueshme dhe dënohen konform ligjit. Oficerëve të policisë duhet t’u*

¹¹ Komisariti nr.1 në Tiranë dhe Komisariti i Fierit.

¹² Raporti i CPT-së i publikuar më 21 Janar të vitit 2009

bëhet e qartë se forca e ushtruar nga ata teksta kryejnë detyrën e tyre, nuk duhet të jetë më shumë seç është e nevojshme, dhe menjëherë sapo personi të vendoset nën kontroll, nuk ka më justifikime për ta goditur atë”.

Përveç rasteve të keq-trajtimit nga ana e policisë, KShH vlerëson në dritën e standarteve të vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së se, në disa raste kushtet në të cilat vendoset personi i shoqëruar, ndaluar ose arrestuar mund të përbëjnë torturë ose trajtim ç’njëzësor dhe degradues. KShH konsideron se kushtet e keqija fizike të disa nga komisariteve të policisë të evidentuara në rubrikën e “*Infrastrukturës dhe Kushteve Fizike të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë*”, të këtij raporti, mund të përbëjnë trajtim jo njëzësor për personat e shoqëruar, të ndaluar dhe arrestuar që mbahen në këto komisaritate. KShH konsideron si tepër shqetësues faktin që në një numër të konsiderueshëm komisaritatesh¹³, si pasojë e mungesës së krevateve, personat ishin të detyruar të flinin në tokë me dyshekë ose batanije.

2.8 Gjendja e kriminalitetit

Kriminaliteti është një ndër fenomenet që sjell pasojë të dëmshme për individin, komunitetin në përgjithësi dhe veprimtarinë e shtetit. Në ndryshim nga vëzhgimet e kryera vitet e kaluara, në fokus të vëzhgimit të kryer gjatë këtij viti ka qenë edhe gjendja e kriminalitetit në rang qyteti ose qarku, kryesisht për sa i takon evidentimit të tendencës së tij në aspektin krahasimor gjatë dy viteve të fundit.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se në pjesën më të madhe të drejtorive të policisë në qarqe, gjendja e kriminalitetit ishte njësoj ose më e lartë në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë natyra e veprave penale ndryshon nga qarku në qark, veprat penale më të përhapura në të gjitha qarqet, ku u krye vëzhgimi, ishin ato kundër jetës dhe shëndetit (dhuna në familje, krimet për shkak të konflikteve të pronësisë, krimet me bazë hakmarrjeje, etj), veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, etj. Në disa qarqe kishte rritje të kategorive të caktuara të veprave penale. Kështu p.sh. në Korçë, për vitin 2011 shënonin rritje krimet në fushën e krimit ekonomik. Në qarkun e Fierit dhe të Lezhës ishin të përhapura krimet kundër pasurisë, kryesisht vjedhjet e pronës dhe veprat kundër personit. Në qytetin e Librazhdit, për shkak të konsumimit të alkoolit dhe si rezultat i problemeve social-ekonomike, ka patur kundravajtje që kanë prishur rendin dhe sigurinë publike në qytet.

KShH vlerëson se veprimtaria për parandalimin dhe luftën e kriminalitetit kërkon një angazhim më të madh të strukturave shtetërore dhe përfshirje më të lartë të aktorëve të shoqërisë civile në këtë veprimtari. Përpunimi i saktë i të dhënave statistikore që administrohen nga komisaritet e policisë dhe kryerja e analizave gjithëpërfshirëse për gjendjen e kriminalitetit dhe faktorët ndikues është një ndër hapat më të rëndësishëm që duhet të ndërmarrin strukturat e policisë në shtetit, në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore.

KShH konsideron shumë të rëndësishëm policimin në komunitet si një ndër aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së strukturave vendore të policisë së shtetit, për të qenë më afër nevojave të komunitetit nëpërmjet realizimit të formave të ndryshme të bashkëpunimit si p.sh zhvillimin e aktiviteteve me karakter ndërfaqësues që shfaqin

¹³ Komisariti i Kamzës, Komisariti nr.2 dhe nr.3 në Tiranë, Komisariti i Pogradecit, *Komisariati i Durrësit*, Komisariti i Shkodrës, Komisariti i Elbasanit, Komisariti i Lushnjës.

interes për publikun. Shembull i mirë në këtë drejtim ishin aktivitetet e zhvilluara për policimin në komunitet në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, në ambientet e së cilës ishin zhvilluar orë të hapura me nxënës të shkollave të mesme të qytetit, lidhur me të drejtat dhe detyrat e tyre, gjatë bashkëjetesës në komunitet.

3. Rekomandime drejtuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Drejtorive të Policisë në Qarqe, Komisariateve të Policisë dhe aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë penale

- KShH, sugjeron përfundimin sa më parë të punimeve në ato komisariate të cilat janë rikonstruktuar rishtaz me qëllim uljen e mbipopullimit të institucioneve të tjera. Gjithashtu, sugjerojmë që në rikonstruksionet që janë përfunduar, të shikohet mundësia e rrethimit të tualeteve dhe dusheve me mbulesa ose me mjete të tjera, me qëllim që të mos jenë të aksesueshëm nga ana pamore për stafin e sigurisë që qëndron mbrapa derës.
- Sugjerojmë që komisariateve, të cilat kanë kushte të këqija infrastrukturore¹⁴, t'u vihen në dispozicion fonde, periodikisht, për të mundësuar kryerjen e disa rregullimeve të nevojshme si mermetime, lyerje, sigurimi i ndriçimit të mjaftueshëm elektrik, sigurimi i krevatave dhe teshave të përshtatshme për fjetje etj. Gjithashtu, sugjerojmë të bëhet, sa më parë, rikonstruksioni i plotë i ambienteve ekzistuese ose të realizohet ndërtim i ri për institucionet e Komisariateve të Sarandës, Krujës, Vlorës, Durrësit, Lushnjës, Librazhdit, Elbasanit dhe Beratit.
- Sugjerojmë të vlerësohen efektivisht nevojat e Drejtorive të Policisë në Qarqe dhe komisariateve për ato mjete logjistike që janë të domosdoshme për mbarëvajtjen normale të punës, si për shembull karburanti, mjetet kompjuterike, mjetet e transportit, mjetet e kontrollit fizik, si dedektivët, etj.
- KSHH sugjeron të shikohen mundësitë e gjetjes së zgjidhjeve alternative në rastet kur në ambientet e dhomave të shoqërimit transferohen persona të alkoolizuar dhe përdorues të lëndëve narkotike, që dëmtojnë ambientet dhe pajisjet e dhomës. Të bashkëpunohet me Spitalet civile në rrethe për të mundësuar spitalizimin e atyre personave, që për shkak të alkoolit të përdorur dhe lëndëve narkotike, nuk kanë aftësinë e nevojshme për të kontrolluar veprimet e tyre dhe e kanë të domosdoshme mbikqyrjen dhe trajtimin e mjekësor, derisa të dalin nga gjendja.
- KShH sugjeron që të sigurohet furnizimi me ujë të ngrohtë dhe pajisja me dushe në komisarietet e Kamzës, Nr.3 në Tiranë, Sarandës, Pogradecit, Durrësit dhe Elbasanit.
- Sugjerojmë të përmirësohen kushtet higjieno sanitare në ambientet e dhomave të sigurisë, dhomave të shoqërimit dhe veçanërisht në ambientet e tualeteve në Komisariatin e Policisë nr.3 në Tiranë, Sarandës, Elbasanit, Pogradecit, etj.
- Sugjerojmë, të shtohet personeli policor në ato qarqe, të cilat për shkak të situatës dhe specifikës së kriminalitetit, nuk mund të mbulojnë ngarkesën e punës me stafin ekzistues. Gjithashtu sugjerojmë të sigurohet për çdo drejtori qarku personeli i nevojshëm mjekësor, me qëllim mundësimin e ekzaminimit mjekësor të menjehershëm pas vendosjes së personit në dhomat e sigurisë, si dhe ofrimin e asistencës së nevojshme mjekësore gjatë qëndrimit në ato ambiente.

¹⁴ Komisaritati i Tiranës¹⁴, Komisaritati i Sarandës, Komisaritati i Durrësit, Komisaritati i Lushnjës, Komisaritati i Librazhdit dhe Komisaritati i Elbasanit.

-
- KShH sugjeron gjetjen e mundësive alternative për ofrimin e ushqimit edhe në ato Komisariate ku ai mungon. Shërbimi catering dhe marrëveshjet me Drejtoritë e IEVP-ve, kanë treguar , në disa raste se mund të jenë një zgjidhje oportune.
 - KShH sugjeron një koordinim më të mirë të punës midis Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të eliminuar vonesat në lëshimin e urdhërave të transferimit nga kjo e fundit për personat e dënuar në mungesë, që qëndrojnë në ambientet e Komisariateve, duke i sistemuar sa më shpejt të këta persona pranë I.E.V.P.
 - Të sigurohet që shoqërimi i personave në komisariate të bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara në ligj. Të unifikohet në të gjitha komisaritet, procedura që ndiqet për marrjen në dorëzim të personave të shoqëruar dhe veprimet e verifikimit që kryhen gjatë kohës së qëndrimit të tyre në komisaritet.
 - Të studiohet mundësia për rishikimin e bazës ligjore për trajtimin e personave të shoqëruar, me qëllim unifikimin e procedurave dhe sigurimin e respektimit më të mirë të të drejtave të tyre.
 - Të mbikëqyret zbatimi efektiv, nga DPPSH, i urdhërit nr.562, dt.16.06.2011 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin dhe vënien në zbatim të “Deklaratës për informimin dhe njohjen me të drejtat ligjore, për personat e arrestuar/ndaluar në Policinë e Shtetit” dhe të merren masa ndaj efektivave që e anashkalojnë atë.
 - Sugjerojmë të afishohen materiale sensibilizuese informuese për të drejtat e njeriut në ato komisariate që kanë mungesë të këtyre materialeve.
 - KSHH sugjeron të zhvillohen trajnime të mëtejshme për ngritjen e kapaciteteve të stafit që ka si detyrë hedhjen e të dhënave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në sistemin elektronik ADAM.
 - Për shkak të problematikës së evidentuar, rekomandojmë që të ketë një koordinim më të mirë, me qëllim që të iniciohen forma të ndryshme bashkëpunimi, midis aktorëve të sistemit të drejtësisë penale (polici, prokurori dhe gjykatë), për evidentimin e problematikës lidhur me dhunën e ushtruar nga policia dhe gjetjen e mënyrave për adresimin e drejtë dhe shqyrtimin e rasteve konkrete të këtij fenomeni.
 - Sugjerojmë, të zhvillohet dhe forcohet më tej policimi në komunitet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme me karakter social. Të organizohen nga policia sa më shumë aktivitete me fëmijë dhe të rinj, me qëllim sensibilizimin e këtij targetgrupi për fenomenin dhe pasojat negative të krimit, si dhe për të mundësuar parandalimin e hershëm të kriminalitetit në të ardhmen, si dhe rritja e bashkëpunimit të policisë me qytetarët.